

**FORUMI**  
për  
**SIGURI**

# Forca e Sigurisë së Kosovës

**mes sfidave aktuale  
dhe vizionit për të ardhmen**

Qershor 2011

## Metodologjia e hulumtimit

Ky hulumtim është i katërti me radhë i Forumit për Siguri, i cili është themeluar nga Forumi për Iniciativa Qytetare (FIQ) dhe Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS).

Forumit për Siguri ka për qëllim të shërbej si platformë e diskutimit në mes organizatave të shoqërisë civile dhe institucioneve për çështjet e sigurisë në vend. Me këtë synohet të nxitet komunikimi dhe studimi i politikave në fushën e sigurisë duke ofruar rekomandime konkrete për përmirësimin e saj. Forumi për Siguri publikon analiza dhe raporte vlerësuese për gjendjen e sigurisë në Kosovë dhe funksionimin e institucioneve përkatëse, duke i plotësuar ato me organizimin e tryezave dhe diskutimeve publike me qëllim të rritjes së ndikimit për përmirësimin të sigurisë në vend.

Ky projekt mbështetet nga Saferworld dhe Balkan Trust for Democracy (BTD).

Përmbajtja e këtyre publikimeve nuk pasqyron në asnjë mënyrë qëndrimin e donatorëve apo të partnerëve tjerë.

Metodologjia e përdorur për hulumtime në kuadër të Forumit për Siguri bazohet kryesisht në hulumtime kualitative që reflekton metoda bashkëkohore të shkencave sociale, duke përfshirë dhe mos u kufizuar në: intervista direkte me akterë kryesor të përfshirë në sektorin e sigurisë; analizimin e legjislacionit ekzistues në kuadër të sektorit të sigurisë në Kosovë; konsultimin e raporteve studimore të publikuara nga organizata të ndryshme vendore e ndërkombëtare; këndvështrimet e mbledhura nga organizimi, pjesëmarrja dhe observimi aktiv i hulumtuesve të Forumit për Siguri në konferenca, debate, grupe të fokusit, si dhe metoda të tjera.

Forumit për Siguri falënderon edhe Grupin Këshillues për kontributin e dhënë në hartimin e këtij raporti.

Autor:  
Skender Përteshi  
Forumit për Siguri

## **Përmbajtja**

<b>METODOLOGJIA E HULUMTIMIT.....</b>	<b>2</b>
<b>PËRMBAJTJA.....</b>	<b>3</b>
<b>PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE .....</b>	<b>4</b>
<b>TË GJETURAT KRYESORE:.....</b>	<b>5</b>
<b>HYRJE .....</b>	<b>6</b>
<b>I. KËNDVËSHTRIMI LIGJOR.....</b>	<b>7</b>
1.1. Vlerësimi i legjislacionit aktual për FSK, si dhe nevojat për plotësimin dhe ndryshimin e tij	8
<b>II. KAPACITETET INSTITUCIONALE TË FSK-SË.....</b>	<b>9</b>
2.1. Procesi i rekrutimit në FSK.....	9
<b>III.QEVERISJA E MIRË NË FSK .....</b>	<b>12</b>
3.1.Respektimi i të drejtave të njeriut, përfaqësimi gjinor dhe teknik në FSK.....	12
3.2. Transparenca e përgjithshme, financiare dhe ndërtimi i imazhit të FSK-së .....	13
3.3. Mbikëqytja parlamentare dhe demokratike e FSK-së .....	15
<b>IV. E ARDHMJA E FSK-SË .....</b>	<b>16</b>
<b>REKOMANDIMET: .....</b>	<b>17</b>
<b>BIBLIOGRAFIA.....</b>	<b>18</b>

## Përmbledhje ekzekutive

Ky hulumtim ka identifikuar sfidat, të arriturat dhe dobësitë në konsolidimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës. Është konstatuar një konsolidim i kufizuar i FSK-së në raport me periudhën trevjeçare të zhvillimit. Brenda këtyre viteve, FSK ka arritur të rekrutojë pjesëtarë aktiv dhe shumica e trajnimeve janë bërë konform planeve. Mbetet shqetësues procesi i jotransparent i rekrutimit të një pjese të pjesëtarëve duke vënë në pikëpyetje rekrutimin e individëve të duhur në këtë strukturë. Poashtu, deri më tani, FSK nuk ka arritur të fillojë trajnimet dhe aktivizojë komponentën rezervë të saj.

Baza ligjore për funksionimin e FSK-së ekziston, megjithatë kanë mbetur pa u hartuar dhe miratuar një pjesë e ligjeve. Vërehet një tendencë për aplikimin e qeverisjes së mirë paralelisht me konsolidimin e institucionit. Megjithatë, dobësitë në këtë drejtim janë të pranishme. Transparenca e përgjithshme dhe financiare e FSK-së është e kufizuar; përfaqësimi i gruas në nivele strategjike është larg nga parashikimet, si dhe mbikqyrja civile e demokratike është në fazën e hershme të zhvillimit.

Është evidentuar një rol tejjet i theksuar i pranisë ndërkombëtare në zhvillimin e FSK-së. Ky rol mund të vështirësojë përpjekjet për fuqizimin e pronësisë vendore dhe për më shumë shkakton varësi të zyrtarëve/pjesëtarëve vendor në raport me asistencën ndërkombëtare.

Vështirësitë në konsolidimin e FSK-së nuk e përjashtojnë vizionin për transformimin e saj në Ushtri të Kosovës. Përpjekjet në këtë drejtim kërkojnë një proces të ri të Rishikimit të Sektorit të Sigurisë në Kosovë, me një përfshirje të gjerë të akterëve qeveritar dhe joqeveritar.

## Të gjeturat kryesore:

- Procesi i rekrutimit dhe seleksionimit në FSK nuk ka qenë shumë transparent dhe nuk ka ndonjë matës që tregon kualitetin e kandidatëve që janë pranuar në FSK.
- Komisioni Parlamentar për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e FSK-së nuk ka qenë shumë aktiv në mbikëqyrjen e FSK-së, si dhe zbatimin e legjislacionit për FSK-në.
- Ka vonesa në rekrutimin e stafit të komponentës aktive dhe rezervë të FSK-së, si dhe gjatë procesit të rekrutimit janë vërejtur parregullësi, janë pranuar kandidatë nga një rajon i caktuar.
- Ka mangësi ligjore në legjislacionin aktual për FSK-në, ngase ende nuk janë miratuar Ligji për Deminim Humanitar, Ligji për Zbarkim Jashtë Vendit, Ligji për Bashkëpunim Ndërkombëtar, Ligji për Pensionimin e Hershëm të pjesëtarëve të FSK-së
- Janë vërejtur mangësi sa i përket transparencës së përgjithshme dhe asaj financiare, si dhe mangësi të mëdha në menaxhimin dhe shpenzimin e buxhetit.
- Mbetet shqetësues fakti për nivelin e ulët të përfaqësimit gjinor dhe etnik në FSK, sidomos sfiduese është përbindja shumë e vogël e pjesëtarëve të komunitetit serb në FSK
- Ende roli i KFOR-it është shumë i lartë në krijimin e FSK-së, që po ndikon në ngadalësimin e zhvillimit të kapaciteteve vendore në FSK. Përkundër reduktimit të trupave të KFOR-it në Kosovë, nuk ka transformim të kompetencave paralelisht me këtë tek FSK.

## Hyrje

Pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, filloi së ndryshuari arkitektura e sigurisë në vend. Plani Gjithëpërfshirës i Ahtisaarit, i cili definoi statusin përfundimtar të Kosovës, ndër të tjera kishte paraparë edhe shuarjen e disa mekanizmave të sigurisë, reformimin e një pjese të institucioneve, si dhe krijimin e institucioneve të reja të sigurisë. Me qenë se Kushtetuta e Republikës së Kosovës, e cila u miratua nga Kuvendi i Kosovës më 15 qershor 2008, inkorporoi pjesë të rëndësishme nga plani i Ahtisaarit, ndryshimet që i parashihte ky dokument në kuadër të kapitullit të sektorit të sigurisë, linte ende disa fusha në përgjegjësi të pranisë ndërkombëtare. Për këtë qëllim, prania ndërkombëtare ushtarake e udhëhequr nga NATO (KFOR) edhe më tutje mbetet institucioni i vetëm përgjegjës për ofrimin e shërbimeve të karakterit të mbrojtjes, duke përfshirë sigurimin e integritetit territorial, si dhe detyrat shtesë në themelimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës. Për më shumë, Kushtetuta në mënyrë të qartë i hapi rrugën shtetit të ri të Kosovës të ketë pushtet më të madh në fushën e zbatimit të ligjit, sigurinë, drejtësinë, gatishmërinë emergjente, kontrollin e kufijve, etj., madje duke i lënë hapësirë që proporcionalisht me ndërtimin e kapaciteteve vendore të institucioneve vendore kompetente të sigurisë, të zhvillohet edhe transferimi i përgjegjësive nga ana e institucioneve ndërkombëtare tek institucionet vendore.

Sipas legjislacionit ekzistues, Forca e Sigurisë së Kosovës është themeluar si forcë civile multnietnike e armatosur lehtë, e cila është e ngarkuar me detyra të cilat nuk janë karakteristike as për policinë dhe institucionet tjera të zbatimit të ligjit, ku përfshihen kryesisht reagimi në rast të katastrofave natyrore dhe ato të shkaktuara nga faktori njeri, deminimi dhe kërkim shpëtimi.<sup>1</sup> Vet themelimi i FSK-së është bërë duke marrë parasysh parimet demokratike të parapara për institucione të sigurisë, siç janë: shërbimi ndaj qytetarëve, repektimi i të drejtave të njeriut, kontrolli civil, mbikëqyrja demokratike, transparencja, llogaridhënia, etj. Andaj, çdo zhvillim dhe avancim i mëtutjeshëm i rolit të kësaj force mbetet peng jo vetëm i përmbyshjes me sukses të misionit të FSK-së, por edhe i përmbyshjes së parimeve të përmendura demokratike, kritere këto të cilat janë të ndërlydhura në mes vete.

Hulumtimi në fjalë synon analizimin e progresit të FSK-së në vitet e para të zhvillimit, si dhe vlerësimin e sfidave me të cilat përballet kjo forcë në arritjen e kapaciteteve të plota operacionale. Pjesa e parë do të vlerësojë bazën ligjore për funksionimin e FSK-së, e cila do të pasohet nga rekrutimi, pajisjet, si dhe zhvillimi i parimeve të qeverisjes së mirë paralelisht me konsolidimin e saj. Poashtu, vëmendje do t'i kushtohet edhe vizionit të FSK-së për të ardhmen. Kjo pasi që vet Plani i Ahtisaarit hap rrugën që 5 vite pas themelimit të kësaj force, të mund të rishikohet roli dhe misioni i saj.

---

<sup>1</sup> Kuvendi i Kosovës, Ligji për Themelimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës, neni 1

## I. Këndvështrimi ligjor

Plani Gjithpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit Kosovës i Marti Ahtisarit (në vijim Plani i Ahtisarit), dhe më pas (duke u bazuar po në këtë dokument) edhe Kushtetuta e Republikës së Kosovës parashikoi themelimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK-së). Plani i Ahtisaarit dhe Kushtetuta shprehimisht parashohin që FSK duhet të themelohet dhe operacionalizohet me mision të kufizuar, por duke lënë hapësirë që pas një periudhe 5 vjeçare do të mund të rishikohej roli, misioni dhe nevojat për zgjerimin e kapaciteteve të kësaj force.<sup>2</sup> Ndërkohë, edhe pse është bazuar në këtë dokument, Kushtetuta vetëm në mënyrë të përgjithësuar përmend FSK-në si forcë kombëtare e sigurisë së Republikës së Kosovës, e cila i shërben sigurisë së qytetarëve të Kosovës, si dhe mund të dërgoj pjesëtarët e saj jashtë vendit në përputhje të plotë me përgjegjësitë e saj ndërkombëtare. Kushtetuta po ashtu garanton edhe përqafimin e parimeve demokratike në kuadër të kësaj force, siç janë: mbrojtja e qytetarëve, kontrolli civil, karakteri profesional, multi-etniciteti dhe diversiteti<sup>3</sup>.

Ndonëse Kushtetuta “arriti” t’i shmanget përkufizimit të kufizuar të rolit dhe misionit të FSK-së, megjithatë Ligji për FSK-në e ka rregulluar mandatin e saj në mënyrë të detajuar. Sipas ligjit, FSK themelohet si forcë civile, multnietnike, e armatosur lehtë, e cila është e ngarkuar me detyra të cilat nuk janë karakteristike as për policinë dhe as organizatat tjera të zbatimit të ligjit, ku përfshihen reagimi në rast të katastrofave natyrore, deminimi, kërkim shpëtimi dhe çështje të tjera. Sipas ligjit, FSK është forcë profesionale me kapacitete fillimisht të kufizuara me gjithsej 2.500 pjesëtarë aktiv dhe 800 pjesëtarë rezervë.<sup>4</sup>

Sa i përket mbikëqyrjes dhe kontrollit të FSK-së, Kuvendi i Republikës së Kosovës, Presidenti, Kryeministri dhe Ministri i MFSK-së përbëjnë zinxhirin e mbikëqyrjes civile të FSK-së, ashtu edhe siç përcaktohet me Kushtetutë dhe me ligj.<sup>5</sup> Poashtu, Qeveria e Republikës së Kosovës ushtron kontrollë transparent, demokratik dhe civil të Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe i përgjigjet Kuvendit të Republikës së Kosovës. Kështu, MFSK ka kontroll dhe administrim të përgjithshëm mbi FSK, duke përfshirë të gjitha fuqitë që bien mbi Komandantin e Forcës së Sigurisë të Kosovës. Kjo ministri është e integruar që nënkupton përbërje të personelit prej 60% të stafit civil dhe 40% të stafit të uniformuar.<sup>6</sup>

---

<sup>2</sup> , Plani Gjithpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, i Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Kombeve të Bashkuara Marti Ahtisaari, 2007, Neni 5

<sup>3</sup> Ibid

<sup>4</sup> Ibid, Neni,

<sup>5</sup> Ligji për Forcën e Sigurisë së Kosovës, Kuvendi i Kosovës, 15 qershor 2008, neni 3.1

<sup>6</sup> Ligji për Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës, Kuvendi i Kosovës, 15 qershor 2008, neni.3.12

## 1.1. Vlerësimi i legjislacionit aktual për FSK, si dhe nevojat për plotësimin dhe ndryshimin e tij

Vlen të theksohet se infrastruktura aktuale ligjore që rregullon fusha të ndërlidhura me FSK-në ende nuk është tërësisht e kompletuar dhe si rrjedhojë pritet të pasurohet me nxjerrjen e ligjet të tjera dhe po ashtu ndryshimin e atyre ekzistuese me qëllim të krijimit të mundësive konform rrethanave të reja në të ardhmen. Tani për tani, në proces janë miratimi i Ligjit për Deminim Humanitar, Ligji për Pensionim të Hershëm në FSK, dhe Ligjit Marrëveshja e Statusit të Forcës (SOFA), mirëpo ende nuk dihet se cila është dinamika e hartimit të tyre dhe mbi të gjitha se a do të miratohen ato brenda vitit 2011.<sup>7</sup> Për më shumë dhe në ndërkohë, miratimi i Ligjit për Aviacionin Luftarak (i cili ende nuk është në agjendë) do t'i mundësonte FSK-së të funksionalizoj komponentën (eskuadrilën) e helikopterëve me anë të së cilës do të rritej efikasiteti i aktiviteteve gjatë misioneve në rast të katastrofave humanitare, të cilët mund të përdorën së bashku me Policinë e Kosovës, si dhe gjithashtu do të krijonte mundësi që të përgatiteshin kapacitetet njerëzore në fushën e aviacionit.<sup>8</sup> Poashtu, për plotësimin e infrastrukturës ligjore është shumë e rëndësishme edhe miratimi i ligjit për bashkëpunimin ndërkombëtar të FSK-së, nëpërmjet të cilit do të përmirësohej bashkëpunimi ndërshtetëror në fushën e sigurisë, si dhe do të mundësohej shkëmbimi i përvojave në fushën ushtarake ndërmjet FSK-së dhe shteteve të ndryshme, të cilat do të ndihmonin dhe do të bënin më të lehtë fillimin e procesit për integrim në programin “Partneritet për Paqe” në fazat e mëvonshme. MFSK ka nënshkruar Marrëveshjen për Zbarkim Jashtë Vendit, por kjo është e pamjaftueshme. Kuvendi i Kosovës duhet të miratojë Ligjin për Zbarkim të FSK-së Jashtë Vendit në të cilin duhet të parashihen qartë procedurat për marrjen e vendimit për zbarkim jashtë vendit, si dhe do të rregullohej statusi i pjesëtarëve të saj, si p.sh. në rast të ndonjë pësimi aksidenti të pjesëtarëve të saj gjatë misionit apo edhe çështje tjera. Në shumë raste, sferat të cilat nuk janë të rregulluara me ligj, janë plotësuar me nxjerrjen e akteve administrative dhe rreguloreve të punës nga ana e MFSK-së, duke përfshirë fusha si: procedura e gradimit; lidhjes së marrëveshjeve ndërkombëtare; zbarkimit të FSK-së për misione paqëruajtëse jashtë vendit; përdorimin e shenjave dhe simboleve; etj.<sup>9</sup> Poashtu, edhe dhënia e informatave dhe bashkëpunimi me publikun dhe mjetet e informimit, është e rregulluar me udhëzim administrativ. Sipas këtij udhëzimi administrativ, zyra e MFSK-së për marrëdhënie me publikun shqyrton kërkesat për intervistime, prononcime, etj., dhe vendimi përfundimtar merret nga ministri i MFSK-së ose përfaqësuesi ligjor.<sup>10</sup>

Dhe së fundi, kur flitet për rishikimin e legjislacionit aktual, vlen të theksohet se FSK po ballafaqohet me ngecjen e pushtetit legjislativ të vendit në nxjerrjen e ligjeve të reja, ndryshimin

<sup>7</sup> Kuvendi i Kosovës, Strategjia Legjislative për vitin 2011

<sup>8</sup> Forumi për Siguri, raporti Menaxhimi i Integruar i Kufirit në Kosovë, Prishtinë, prill 2011

<sup>9</sup> <http://www.mksf-ks.org/repository/docs/fletepalosja-Shqip.pdf>

<sup>10</sup> Udhëzimi Administrativ nr. 05/2009 mbi dhënien e informatave dhe komunikimin me mjetet e informimit për Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës, prill 2009, neni 4



apo amandamentimin e tyre, sidomos në fushën e emergjencave civile. Ligji për mbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera ende vijon të mbetet ai i miratuar në periudhën e UNMIK-ut, kur FSK as që kishte ekzistuar. Fakt tjetër që vlen të theksohet është edhe nevoja për ndryshimin e Kushtetutës dhe Ligjit të FSK-së, me qëllim të avancimit të mëtutjeshëm të rolit të FSK-së. Poashtu, vlen të përmendet se aktualisht është themeluar një komision i cili ka për qëllim fillimin e procedurës për ndryshimet kushtetuese. Andaj, ky do të mund të ishte rast i volitshëm që të hapet debati edhe për amandamentimin e pjesës që e rregullon misionin dhe mandatin e FSK-së.<sup>11</sup>

## II. Kapacitetet institucionale të FSK-së

Deri më tani e gjithë përpjekja institucionale për funksionalizimin e FSK-së ishte drejtuar në ngritjen e kapaciteteve operacionale me qëllim të ushtrimit të përgjegjësive të saj brenda misionit ekzistues si forcë civile e armatosur lehtë, e specializuar në çështjet e reagimit emergjent. Andaj, në një masë kjo forcë edhe ka arritur t'i përmbushë kapacitetet e nevojshme fillestare operacionale në pajtim me standardet e parashtruara nga NATO si mbikqyrëse e këtij procesi, në ndërkohë që është duke u punuar për arritjen e kapaciteteve të plota me qëllim të operacionalizimit të mëtutjeshëm të saj. Aktualisht kjo forcë është në fazën përfundimtare të kompletimit të numrit të pjesëtarëve të saj dhe pajisjen e tyre me pajisje të nevojshme për ushtrimin e aktiviteteve të përditshme.

FSK, deri më tani ka arritur aftësitë e saja profesionale në fushat e deminimit, kërkim shpëtimit, dhe për eliminimin e materieve të rrezikshme. Shkathtësitë profesionale të arritura nga FSK tashmë janë dëshmuar sidomos gjatë intervenimit humanitar gjatë vërshimeve në Shqipëri në vitin 2010, por edhe në heqjen e mbetjeve eksplozive nga lufta në Kosovë.

### 2.1. Procesi i rekrutimit në FSK

Në fillim, procesi i rekrutimit ishte mjaft i përfolur për shkak të defekteve të vërejtura. Sidomos përfshirja e ish-pjesëtarëve të TMK-së ishte mjaft sfiduese për FSK-në, ngase që në fillim dihej se të gjithë pjesëtarët e TMK-së nuk mund të inkorporoheshin në forcën e re të Kosovës. Kjo për shkak të numrit të kufizuar të paraparë për FSK-në, që ishte në fakt më i vogël se në ish-TMK, si dhe për arsye se kjo forcë (FSK) synonte ta krijonte identitetin e saj, i cili ishte edhe ligjërisht i ndarë nga identiteti i TMK-së. Prandaj, procesi i selektimit të këtyre pjesëtarëve në FSK nuk arriti të mbyllej pa ngjallur pakënaqësi tek pjesa e ish-pjesëtarëve të TMK-së të mbetur jashtë këtij procesi. Për më shumë, edhe vetë përzgjedhja e stafit menaxhues të FSK-së duke filluar prej komandantit dhe eprorëve të lartë, shkaktoi vonesa së paku një vit, si pasojë e ndërhyrjeve dhe

---

<sup>11</sup> Për më shumë lidhur me të ardhmen e FSK-së, shih pjesën e fundit të publikimit

presionit politik, të cilat më vonë ndikuan edhe në shkaktimin e vonesave në rekrutimin e pjesëtarëve tjerë të FSK-së.

Sipas objektivave të cilat parashihen edhe në legjislacionin në fuqi, FSK duhet të kompletoj numrin prej 2.500 pjesëtarëve aktiv dhe 800 rezervë, mirëpo faza e rekrutimit ka shkuar me një proces relativisht të ngadaltë.<sup>12</sup> Deri më tani janë rekrutuar rreth 2.300 pjesëtarë aktiv, kurse pjesa e komponentës rezervë, pavarësisht se është raportuar për përzgjedhjen e gjeneratës së parë, ende nuk ka filluar trajnimet dhe si e tillë konsiderohet e pakonsoliduar. Përzgjedhja është ende në proces e sipër, ndërkohë që përgjegjësinë për mbështetjen dhe monitorimin e procesit të themelimit të FSK-së që në fillim e mori përsipër KFOR-i. KFOR së bashku me strukturat udhëheqëse të FSK-së kanë hartuar të gjitha politikat dhe planet për trajnimin e pjesëtarëve të rinj të Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Megjithatë, raporti në fjalë shtron si çështje kualitetin e individëve të rekrutuar dhe se a janë marrë parasysh kriteret e vendosura për rekrutimin e personave më të aftë në këtë institucion. Në fakt, observimi i hulumtuesve gjatë këtyre dy-tre viteve të konsolidimit të FSK-së ngre dyshime për mundësinë e rekrutimit të personave me mungesë të përgatitjeve shkollore, profesionale apo fizike, të cilët kanë mundur të rekrutohen në bazë të preferencave subjektive. Ka pasur madje dyshime që në procesin e rekrutimit të pjestarëve të FSK-së ka pasur presione të karakterit politik dhe po ashtu ndikim të tjera që ndërlidhen me nepotizmin dhe krijimin e klaneve.<sup>13</sup> Disa raporte kanë konstatuar tendenca që komisioni përzgjedhës në raste të caktuara të mos e ketë marrë parasysh performancën dhe rezultatin e testeve të kandidatëve, por të ketë vepruar në mënyrë preferenciale në bazë të rajonit prej nga vinin kandidatët. Për më shumë, njëri ndër ish-zyrtarët ndërkombëtar kishte ngritur shqetësimin për përqendrimin e një numri shumë të madh të kandidatëve që vinin nga po i njëjti rajon, ndërkohë që nga shumë rajone tjera ka një numër simbolik të të rekrutuarve.<sup>14</sup> Këtë konstatim e fuqizon edhe më shumë fakti se procesi i rekrutimit të pjestarëve të FSK-së ka qenë plotësisht jo-transparent, në të cilën cikli i rekrutimit dhe verifikimit ka funksionuar vetëm në linjën FSK-KFOR dhe me një mbikëqyrje të kufizuar të disa zyrtarëve të Zyrës Ndërkombëtare Civile. Rekrutimi i pjesëtarëve që nuk plotësojnë kriteret dëmton konsolidimin e këtij institucioni që në fillim të zhvillimit të saj, si dhe sfidon efikasitetin e saj në fazat e mëvonshme.

Trajnimet që organizohen nga ana e FSK-së dhe KFOR-it përfshijnë trajnimet themelore bazike për oficerët dhe nënoficerët e FSK-së në Qendrën e Trajnimeve dhe Doktrinës në Ferizaj.<sup>15</sup> Komponentja akademike plotësohet nga universitet civile-private në mungesë të një universiteti apo fakulteti të veçantë për nevoja të FSK-së. Përderisa kufizimet buxhetore pamundësojnë

---

<sup>12</sup> Intervistë me gjeneral Ramadan Qehaja, Drejtor i Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë, Prishtinë 02-06-2011

<sup>13</sup> Kosovo Security Transition, A critical study into establishment of Kosovo Security Force Ade Clewlow, OSLO 2010

<sup>14</sup> Ibid:

<sup>15</sup> Intervistë me një analist të çështjeve të sigurisë (anonim) 27-05-2011

themelimin e universitetit së paku në këtë fazë, mungesa e një instituti për hulumtime dhe analiza në kuadër të FSK-së përbën një nga mangësitë në avancimin akademik të pjesëtarëve dhe të institucionit në përgjithësi.

Kur flasim për rolin e pranisë ndërkombëtare, atëherë duhet theksuar se KFOR-i ende mbetet fuqishëm i angazhuar në trajnimin e FSK-së, dhe nuk vërehet ndonjë gatishmëri institucionale që vendorët të marrin kryesisht kompetencat. Me fjalë të tjera, NATO-ja, përkatësisht KFOR-i, ka rolin kyç në ndërtimin dhe operacionalizimin e FSK-së.<sup>16</sup> Roli shumë i madh i bashkësisë ndërkombëtare në themelimin dhe zhvillimin e FSK-së po vështirëson përpjekjet e zhvillimit të pronësisë vendore në sektorin e sigurisë. Kjo mund të ndikoj në zhvillimin e kapaciteteve të institucioneve lokale të sigurisë, si dhe mund t'i bëjë ato të varura nga asistenca ndërkombëtare. Indikativ në këto relacione të ndjeshme ishte edhe suspendimi i përkohshëm i marrëdhënieve me FSK-në nga ana e KFOR-it në vitin 2010, e cila ndodhi për shkak të paradës së FSK-së me armë, veprim i cili është bërë pa marrjen e lejes nga ana e KFOR-it. Kjo na tregon se ende KFOR-i ka përgjegjësinë e plotë për të gjitha veprimet e FSK-së, dhe roli i pronësisë lokale në aktivitetet vendimmarrëse në FSK është shumë i kufizuar.

MFSK dhe FSK aktivitetin e tyre e ushtrojnë duke u mbështetur nga mjetet që ndahen nga buxheti i Kosovës dhe donatorët e ndryshëm. Forca e Sigurisë së Kosovës është përballur me shumë sfida për ndërtimin e hapësirave punuese dhe pajisjeve për ushtrimin e aktiviteteve, siç janë: deminimi, kërkim-shpëtimi, pajisjet kundër zjarrit etj.<sup>17</sup> Forca e Sigurisë së Kosovës mbështetet kryesisht nga Fondi i Mirëbesimit i NATO-s, i cili u themelua për ri-sistemimin e pjesëtarëve të TMK-së dhe mbështet shumë projekte në ndërtimin e objekteve të FSK-së, programe dhe trajnime të ndryshme.

Deri më tani me ndihmën e donacioneve kryesisht të shteteve anëtare të NATO-s, si dhe mjetet e buxhetit të Republikës së Kosovës, është investuar mjaft në ndërtimin e objekteve të reja, si dhe riparimin e atyre ekzistuese. Gjithashtu janë blerë edhe pajisje tjera për deminim, kërkim-shpëtim dhe shuarjen e zjarreve. Pjesëtarët e FSK-së vitin e kaluar janë pajisur edhe me armatim të lehtë, i cili kontrollohet dhe ruhet nga ana e Forcës së Sigurisë së Kosovës. Poashtu, FSK është pajisur edhe me makineri ushtarake kryesisht nga Gjermania dhe Danimarka. Nuk kishte ndonjë standardizim të pajisjeve që i janë dhuruar FSK-së ose që janë blerë nga ana e FSK-së. Janë kryesisht shumë lloje të modeleve të pajisjeve që po e pamundëson mirëmbajtjen e tyre.<sup>18</sup> Janë bërë gabime në nënshkrimin e kontratave për blerjen e pajisjeve me anë të së cilave nuk është paraparë mirëmbajtja e tyre. Në përgjithësi, në FSK nuk ka ndonjë plan se si duhet të

---

<sup>16</sup> Themelimi, operacionalizimi dhe funksionimi demokratik i Forcës së Sigurisë së Kosovës- QKSS, qershor-2008

[www.qkss.org/web/images/content/PDF/Themelimi,%20operacionalizimi%20dhe%20funksionimi%20demokratik%20i%20Forc%C3%ABs%20s%C3%AB%20Siguris%C3%AB%20s%C3%AB%20Kosov%C3%ABs%20-%20dokument%20i%20politikave.pdf](http://www.qkss.org/web/images/content/PDF/Themelimi,%20operacionalizimi%20dhe%20funksionimi%20demokratik%20i%20Forc%C3%ABs%20s%C3%AB%20Siguris%C3%AB%20s%C3%AB%20Kosov%C3%ABs%20-%20dokument%20i%20politikave.pdf)

<sup>17</sup> Revista e MFSK, Ngritja, sfidat dhe sukseset, Prishtine 2010

<sup>18</sup> Intervistë me një analist të çështjeve të sigurisë (anonim), Prishtinë 27-05-2011

menaxhohen pasuritë të cilat i posedon FSK-ja, poashtu nuk ka ndonjë listë të saktë të pasurive të FSK-së dhe ato të trashëguara nga TMK-ja.<sup>19</sup>

Kur flasim për menaxhimin e buxhetit si dhe ndarjen e prioriteteve për shfrytëzimin e tij, vërehen mangësi në këtë fushë. Në vitin 2009, Qeveria e Kosovës ndau 21 milionë euro për FSK-në, por vetëm 62% e këtij buxheti është përdorur dhe FSK ka kërkuar në vitin 2010 rritje për 10 milionë euro të tjera. Komisioni Parlamentar për FSK është themeluar në vjeshtën e vitit 2009, por nuk ka shënuar ndonjë performancë domethënëse. Përkundër aktiviteteve dhe përgjegjësi që ka përpara, mos-shpenzimi i buxhetit tregon që në FSK nuk ka kapacitete të mjaftueshme për planifikimin dhe menaxhimin e buxhetit dhe projekteve. Për vitin 2010 buxheti i MFSK-së dhe FSK-së u rritë, por poashtu ka rritje edhe të donacioneve të jashtme për projektet e ndryshme të FSKs-ë. Përkundër mos shfrytëzimit të një pjese të madhe të buxhetit, MFSK ka bërë kërkesë për rritje të buxhetit edhe për 10 mil euro, andaj krahas kërkesës për shtim të aktiviteteve dhe projekteve, MFSK duhet të ketë parasysh edhe rekrutimin e stafit adekuat profesional që merret me planifikimin e aktiviteteve dhe mënyrën e shpenzimit të buxhetit.

### **III. Qeverisja e mirë në FSK**

Mëposhtë janë të elaboruara disa segmente të qeverisjes demokratike që FSK duhet t'i zhvilloj paralelisht me konsolidimin e saj. Është shumë me rëndësi të analizohet progresi i arritur në krijimin e praktikave të qeverisjes së mirë nga ky institucion, duke përfshirë: respektimin e të drejtave të njeriut; përfaqësimin gjinor dhe etnik; bashkëpunimin me institucionet e tjera të sigurisë, transparenca, mbikëqyrja demokratike.

#### **3.1. Respektimi i të drejtave të njeriut, përfaqësimi gjinor dhe teknik në FSK**

Një ndër parimet bazë në të cilën është ndërtuar sektori i sigurisë në Kosovë është respektimi i të drejtave dhe lirive të njeriut. Sipas zyrtarëve, MFSK dhe FSK kanë themeluar Departamentin për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, si dhe Inspektoratin e FSK-së, të cilët janë përgjegjës për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në FSK. Këta mekanizma kanë për detyrë që të krijojnë mundësi të barabartë për të gjithë pjesëtarët pa dallim nacionaliteti, religjioni, kombësie, apo etnie. Inspektorati i ndihmon qytetarët e Kosovës dhe shërbyesit civil duke i hetuar ankesat në rastet të cilat janë të përfshirë pjesëtarët e FSK-së.<sup>20</sup> Megjithatë, nuk është evidentuar ndonjë shkelje e madhe të të drejtave të njeriut në fazën fillestare të ndërtimit të FSK-së. Disa raste do të mund të jenë trajtuar në nivel të departamentit, mirëpo nuk dihet numri i saktë. Në raport me Zyrën e

---

<sup>19</sup> Raporti i Auditorit të Përgjithshëm për MFSK - 2010

<sup>20</sup> Ibid:

Ombudspersonit, është evidentuar një rast i deklarimit të një pjesëtari të FSK-së për shkeljen e të drejtave të njeriut dhe atë në vitin 2009.<sup>21</sup>

Aspekt tjetër në sferën e respektimit të të drejtave të njeriut është edhe përfaqësimi gjinor dhe etnik në FSK. Sa i përket përfaqësimit gjinor, FSK krahasuar me Policinë e Kosovës ende mbetet larg objektivave të parapara me përfaqësimin gjinor, edhe pse një krahasim i tillë nuk është indikator i saktë për vet faktin që policia është formuar që 12 vite.<sup>22</sup> Aktualisht prej 2.366 sa është raportuar numri i përgjithshëm i stafit të uniformuar dhe atij civil, deri më tani vetëm 146 janë femra që është rreth 5.7 % në total. Megjithatë, në aspektin vlerësues si kriter kyç matës është pozicionimi i femrës në pozita të larta vendimarrëse dhe se është shqetësues fakti se ka numër shumë të vogël të femrave që udhëheqin pozita të larta graduese dhe menaxheriale në FSK.<sup>23</sup> Me fjalë të tjera, vlen të theksohet se në nivel vendimmarrës, FSK ka ngecur mjaft në krijimin e mundësive të barabarta sidomos kur bëhet fjalë për promovimin e gruas në pozita menaxheriale. Kur flitet për përfaqësimin etnik në FSK vlen të theksohet se kjo është një pikë mjaft sfiduese. Megjithëse qasja e barabartë në FSK edhe për komunitetet jo-shumicë është e garantuar si me Kushtetutë po ashtu edhe me ligj, inkuadrimi në veçanti i komunitetit serb ka qenë deri më tani mjaft i vështirë. Një gjë e tillë ka ndodhur pa marrë parasysh faktin se FSK dhe MFSK vazhdimisht janë përpjekur për t'i inkurajuar pjesëtarët e komuniteteve që të jenë pjesë e forcës së sigurisë. Përsa i përket komuniteteve pakicë jo- serbe, përfaqësimi i tyre në FSK është rreth 5.6% i totalit të të punësuarve në këtë forcë.<sup>24</sup> Mirëpo, nga 7% sa planifikohet të jenë pjesëtarë të komunitetit serb, deri më tani janë punësuar në këtë forcë vetëm 0.5%.<sup>25</sup> Përderisa vërehet një shtim i interesimit nga ky komunitet që t'i bashkangjitet kësaj force, sfidë mbetet ndikimi i madh i Beogradit zyrtar dhe qarqet radikale të këtij komuniteti, të cilët hapur bëjnë presion tek serbët lokal që të mos i bashkohen kësaj force.

### 3.2. Transparenca e përgjithshme, financiare dhe ndërtimi i imazhit të FSK-së

Transparenca është element i rëndësishëm me të cilën matet qeverisja e mirë në FSK. Në kuadër të FSK-së është themeluar Zyra për Marrëdhënie me Publikun dhe Mediat. Megjithëse kjo zyrë ka kohë që funksionon, transparenca nuk ka qenë në nivel të duhur. Konkretisht dhe ndër të tjera, edhe procesi i rekrutimit nuk ka qenë aq transparent përkundër monitorimit nga ana e KFOR-it dhe ICO-së. Edhe në raport me të dhënat e tjera dhe sidomos ato për pajisjet, kontrollin e brendshëm e informacione të tjera, zyra në fjalë ka pasur hezitime që të jetë më transparente dhe

<sup>21</sup> Raporti i QKSS- Vlerësimit të Rolit të Institucioneve të Pavarura Shtetërore në Reformimin e Sektorit të Sigurisë së Kosovës <http://qkss.org/nee/index.php?section=nees&cmd=details&neesid=128&teaserId=22>

<sup>22</sup> Ne policinë e Kosovës numri femrave pjesëtare është 1225 pjesëtar apo 14.74 %, kurse numri i pjesëtareve jo shqiptar në Policinë e Kosovës është 937 pjesëtar ose 13.54 %.

<sup>23</sup> Interviste me një njohës të çështjeve të sigurisë Prishtinë 18-05-2011

<sup>24</sup> Bazuar në të dhënat statistikore të Ministrisë së Forcës së Sigurisë së Kosovës

<sup>25</sup> Ibid:

në disa raste nuk është respektuar afati prej 15 ditësh që parashihet në Ligjin për Qasje në Dokumente Zyrtare.

Pavarësisht mungesës së transparencës së FSK-së, fushatat sensibilizuese gjatë rekrutimit kanë qenë të mëdha dhe si të tilla janë mbuluar rregullisht nga mediat vendore. Megjithatë, fushata sensibilizuese për rekrutim nuk nënkupton domosdoshmërisht ngritjen e imazhit të këtij institucioni të ri, ngase opinionin kosovar nuk është shumë i informuar me progresin e FSK-së. Këtë e vërteton edhe matja e fundit e besueshmërisë së opinionit publik në të cilën besueshmëria pësoi një rënie të madhe në 55%, krahasuar me vitin e kaluar që ishte në 75%.<sup>26</sup> Në përgjithësi, FSK nuk ka ndonjë platformë të qartë komunikuese me opinionin publik.

Legjislacioni i FSK-së nuk ka dispozita të veçanta të cilat rregullojnë fushën e transparencës financiare dhe prokurimit publik, andaj të gjitha aktivitetet financiare dhe të prokurimit publik duhet të jenë në pajtim me Ligjin për Financat Publike dhe Ligjin për Prokurim Publik.

Ligji për Menaxhimin e Financave Publike në mënyrë të qartë ka rregulluar procedurat e raportimit të buxhetit, si dhe afatet kohore të raportimit, dhe i cili garanton transparencë dhe qasje në të gjitha linjat buxhetore.

Hulumtimi ka vërejtur mangësi të kapaciteteve administrative në departamentet buxhetore dhe prokurimit, rezultate të cilat janë shqetësuese. Në veçanti hulumtimi veçon mangësitë e resurseve njerëzore në planifikimin buxhetor dhe prokurim, si dhe mekanizmave të brendshëm të auditimit dhe kontrollit. Prandaj, puna e tyre është larg nivelit të dëshiruar. Mekanizmat e planifikimit të buxhetit dhe prokurimit janë në fazat fillestare të zhvillimit të tyre, si dhe puna dhe aktivitetet e deritanishme të tyre nuk kanë qenë të kryera në mënyrë efikase.

Krahasuar me periudhën e vitit 2009, MFSK kishte rritje të buxhetit në periudhën e mëvonshme, kurse tani në vitin 2011, për FSK janë ndarë 35 milion euro nga buxheti i Kosovës, si dhe të hyrat nga donacionet tjera. Është mëse e domosdoshme që krahas rritjes së aktiviteve dhe buxhetit, MFSK duhet të rritë kapacitetet e saja të auditimit të brendshëm, planifikimit buxhetor dhe prokurimit, sepse kapacitetet ekzistuese nuk janë në nivelin e dëshiruar.

---

<sup>26</sup> Saferworld, raporti: Perceptimet e publikut për sigurinë në Kosovë-koha për të vepruar, Prishtinë 2011

### 3.3. Mbikëqyrja parlamentare dhe demokratike e FSK-së

Institucionet të cilat edhe me Kushtetutë kanë mandatin që të ushtrojnë mbikëqyrjen dhe kontrollin e jashtëm të FSK-së janë: Kuvendi i Kosovës, Presidenti i Kosovës, Institucionet e Pavarura Shtetërore, Shoqëria Civile dhe Mediat.

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e FSK-së ka mandatin që të ndajë dhe monitoroj buxhetin për MFSK, si dhe të japë pëlqimin për të gjitha kontratat apo projektet që kapin vlerën e mbi një milion euro, por një gjë e tillë ende nuk ka ndodhur. Në përgjithësi mbikëqyrja parlamentare e sektorit të sigurisë në Kosovë është në fazat e hershme të zhvillimit të saj. Komisioni për Mbikëqyrjen e FSK-së përballet me shumë sfida për ushtrimin e aktivitetit të tij të garantuar me ligj. Ka mungesa të kapaciteteve njerëzore dhe profesionale brenda komisionit, të cilët kanë për obligim kontrollin parlamentar të FSK, mbikëqyrjen e progresit të MFSK, si dhe mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit që rregullon MFSK, e që deri më tani ende nuk ka ndodhur.

Nisur nga Kuvendi i Kosovës, në këte vit deri në muajin maj përveç një vizite të delegacionit nga komisioni përkatës parlamentar në FSK, nuk është vërejtur ndonjë bashkëpunim aktiv i kësaj force me Kuvendin e Kosovës. Gjithashtu, që nga themelimi i FSK-së asnjëherë deri më tani në komisionet parlamentare mbikëqyrëse për FSK-në nuk janë diskutuar çështjet buxhetore të FSK-së, siç janë tenderët mbi një milion euro etj., edhe pse për një gjë të tillë kanë qenë të obliguar me ligj.<sup>27</sup> Vlerësim i ngjashëm vlen edhe për institucionet e pavarura. Rekomandimet e Auditorit Gjeneral për FSK që u dhanë në vitin 2009, nuk janë marrë shumë parasysh nga ana e zyrtarëve të MFSK-së, madje nuk është hartuar asnjë plan veprimi për përmbushjen e këtyre rekomandimeve, si dhe të rregullimit të planit të auditimit e të raportimit financiar në MFSK.

Mungesë bashkëpunimi në nivel të duhur ka pasur edhe me rastin e hartimit të planeve dhe strategjive brenda FSK-së. Përveç një ekipi këshillues të NATO-s dhe zyrtarëve të MFSK-së, pothuajse asnjëherë nuk janë ftuar të marrin pjesë përfaqësues të shoqërisë civile në këto punime.<sup>28</sup> Bashkëpunimi i FSK-së me organizatat e shoqërisë civile dhe me qytetarët do ta ngriste imazhin dhe besimin e qytetarëve për FSK-në, si dhe do ta ngriste transparencën përbrenda këtij institucioni. Poashtu, roli i organizatave të shoqërisë civile mund të shërbej edhe si eksperiencë alternative për vazhdimin e zhvillimit të kapaciteteve profesionale të FSK-së, si dhe do të ngriste edhe më tutje parimin e mbikëqyrjes demokratike të institucioneve të sigurisë.

---

<sup>27</sup> DCAF and KCSS Paper - Parliamentary and Oversight Criteria on Progress

<sup>28</sup> Intervistë me Hajrush Kurtaj, drejtori i Zyrës për Marrëdhënie Ushtarako-Civile në MFSK, Prishtinë 18-05-2011

## IV. E ardhmja e FSK-së

Ky publikim, krahas vlerësimit të progresit për zhvillimin e FSK-së, synon të adresoj shkurtimisht aspektin e transformimit të këtij institucioni në të ardhmen e afërm, konform kushteve dhe rrethanave tjera. Kjo për arsye se Plani i Ahtisaarit lejon rishikimin e mandatit të kësaj strukture pas një periudhe pesë vjeçare (në vitin 2013). Poashtu, edhe kërkesat e një pjese të elitës politike për rishqyrtimin e mandatit të FSK-së kërkojnë një pozicionim të shoqërisë civile karshi kësaj çështje.

Është mëse e vërtetë se FSK-ja gjatë zhvillimit të saj ka dobësi në disa segmente dhe disa gjetje të lartpërmendura janë shqetësuese. Megjithatë, këto dobësi nuk e përjashtojnë domosdonë e rishqyrtimit të mandatit “politik” të saj. Kjo për faktin se FSK-ja është dizajnuar në bazë të një konteksti politik tjetër duke balancuar “konstalacionin e forcave në rajon” dhe duke mos “irituar” disa shtete fqinje. Dizajnesit e FSK-së kanë qenë shumë të kujdesshëm që mandati dhe struktura e saj të mos jenë krejtësisht të karakterit ushtarak, megjithatë disa aspekte thjeshtë ushtarake janë ‘kamufliuar’ që të mos shkaktojnë reagime nga akterë të ndryshëm ndërkombëtar. Për më shumë, edhe tendencat e Serbisë për ta trajtuar si kërcënim ushtarak një strukturë prej 2.500 pjesëtarëve, si të tilla nuk qëndrojnë.<sup>29</sup>

Në fakt, pozicioni politik i Kosovës është tjetër krahasuar me atë të viteve 2006-2008, kështu që nevoja për riformulimin e FSK-së në Ushtri të Kosovës duhet të merret parasysh tash e tutje, sidomos ndryshimet e ardhshme kushtetutese duhet të konsiderojnë këtë aspekt. Ky ndryshim i mandatit ‘politik’ të FSK-së nuk duhet të reflektoj domosdoshmërisht ndonjë ndryshim të menjëhershëm të mandatit dhe detyrave aktuale. Megjithatë, kjo do të nënkuptonte kalimin në ndonjë fazë tjetër të zhvillimit. Për më shumë, riformulimi në Ushtri e Kosovës rrjedhimisht do ta zvogëlonte ndikimin e madh ndërkombëtar për momentin dhe si e tillë do të fuqizohej pronësia vendore në proceset e sigurisë në vend. Aq më tepër se këto ndryshime do të konkretizoheshin në momentin kur prania e KFOR-it në vend do të jetë minimale dhe si rezultat kërkon gati kalimin e plotë të përgjegjësive tek policia dhe ushtria e Kosovës.

Mandati i tanishëm frenon dukshëm përpjekjet e Kosovës për integritet euro-atlantike dhe kjo vërehet sidomos në mos-anëtarësimin në Programin e NATO-s “Partneritet për Paqe”. Edhe pse procesi i integritetit në NATO është kryesisht në përgjegjësi të politikës së jashtme, vet fakti që nuk ka politika të mbrojtjes dhe shtetet nuk mund të ju referohen strukturës aktuale si ushtri, vështirëson negociatat për fillimin e anëtarësimin në këtë organizatë. Në këtë kontekst, do të hapeshin mundësitë për bashkëpunim me shtete tjera dhe sidomos hapja e mundësive për pjesëmarrje në misionet paqëruajtëse jashtë vendit. Struktura e ardhshme ushtarake do të mund të kontribuonte me njësi të specializuara, sidomos me njësi të deminimit dhe mbrojtjes civile. Kjo

---

<sup>29</sup> Strategjia Nacionale e Sigurisë së Serbisë  
<http://merln.ndu.edu/whitepapers/SerbiaNationalSecurityEnglish2009.pdf>



për arsye se që të dy komponentet janë zhvilluar jo vetëm në FSK, por edhe në ish strukturën e TMK-së.

Përkundër progresit të arritur deri më tani, për kohën e mbetur FSK-ja duhet të përshpejtoj aktivitetet e saja në arritjen e kapaciteteve të plota operationale të cilat parashihen edhe në Planin e Ahtisarit, si dhe në Ligjin për FSK, dhe paralelisht duhet të punohet në përgatitjet për fazën e ndryshimit të misionit dhe mandatit të FSK-së, bazuar në vlerësimet nga prania ndërkombetare ushtarake në Kosovë, siç parashihet edhe me Kushtetutën e Kosovës, që pritet të ndodhë në vitin 2013.

Transformimi i FSK-së në Ushtri duhet të bëhet në bazë të një procesi të ri të rishikimit të sektorit të sigurisë në Kosovë, duke përfshirë akterë qeveritar, shoqërinë civile, mediat, përfaqësues të jetës akademike, si dhe një asistencë të kufizuar ndërkombëtare. Struktura dhe investimet e deritanishme qofshin kadrovike, materiale apo të tjera, do të shërbenin si bazë dhe vazhdimësi për strukturën e ardhshme ushtarake.

## **Rekomandimet:**

- Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës (MFSK) duhet të siguroj që rekrutimi i pjesëtarëve të bëhet në bazë të meritave dhe përgatitjes shkollore e fizike të rekrutëve e jo në bazë të preferencave subjektive;
- Deri në fund të vitit 2011, Ministria e FSK-së duhet të kompletoj rekrutimin e komponentës aktive të saj (2.500 pjesëtarë), kurse deri në mesin e vitit 2012 të kompletoj rekrutimin dhe trajnimin e komponentës rezervë (800 pjesëtarë);
- Duhet bërë themelimi i një instituti shkencor në kuadër të FSK-së, i cili do të bënte hulumtime shkencore për nevoja të institucionit;
- Roli shumë i madh i pranisë ndërkombëtare në funksionalizimin e FSK-së vështirëson përpjekjet për pronësinë vendore në proceset e zhvillimit të sektorit të sigurisë. Prania ndërkombëtare duhet gradualisht të filloj bartjen e përgjegjësiive të mbetura në institucionet vendore;
- Transparenca e FSK-së është në nivel të ulët. Ministria duhet të bëjë përpjekje për të lejuar qasje në informacione zyrtare sipas ligjit për qasje në dokumente zyrtare;
- Komisioni Parlamentar për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e FSK-së duhet të filloj së shqyrtuari të gjitha kontratat në FSK që kalojnë vlerën prej një milion euro;

- Krahas operacionalizimit të FSK-së, të filloj procedura për transformimin e këtij institucioni në ushtri. Kjo të bëhet në bazë të një rishikimi të ri të sektorit të sigurisë në vend, i cili duhet të jetë konform rrethanave dhe kushteve të reja në vend.

## **Bibliografia**

1. Kuvendi i Kosovës, Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 2008
2. Kuvendi i Kosovës, Ligji për Themelimin e MFSK, 2008
3. Kuvendi i Kosovës, Ligji për Shërbim në FSK, 2008
4. Kuvendi i Kosovës, Ligji për Menaxhimin e Financave Publike, 2007
5. Ligji për Prokurim
6. Plani Gjithëpërfshirës i Presidentit Ahtisari për Statusin Final të Kosovës, 2008
7. Qeveria e Kosovës, Marrëveshja për Zbarkim Jashtë Vendit, MFSK 2009
8. Qeveria e Kosovës, Marrëveshja për Bashkëpunim Ndërmjet Shteteve, MFSK 2009
9. DCAF & KCSS, Paper- Parliamentary and Oversight Criteria on Progress
10. Kuvendi i Kosovës, Strategjia Legjislative e Kuvendit të Kosovës, 2011
11. Qeveria e Serbisë, Strategjia Nacionale e Sigurisë së Serbisë, Ministria e Mbrojtjes 2009
12. QKSS, Kontekst Analiza e Reformimit të Sektorit të Sigurisë në Kosovë, Prishtinë 2011
13. Saferworld, raporti: Perceptimet e publikut për sigurinë në Kosovë-koha për të vepruar, Prishtinë 2011
14. Forumi për Siguri, raporti: Menaxhimi i integruar i kufirit në Kosovë, Prishtinë 2010
15. QKSS, Themelimi, operacionalizimi dhe funksionimi demokratik i Forcës së Sigurisë së Kosovës, QKSS Prishtinë 2009
16. QKSS, Raporti: Funksionet e kontrollit të institucioneve të pavarura në sektorin e sigurisë, Prishtinë, korrik 2010
17. Forumi për Siguri, raporti: Sektori i sigurisë në Kosovë dy vjet pas pavarësisë, Prishtinë, shtator 2010

18. NUPI: Tranzicioni i sigurisë në Kosovë- një studim kritik mbi themelimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës , Oslo 2010

### **Intervistat:**

1. Intervistë me z. Hajrush Kurtaj, udhëheqës i Departamentit për Marrëdhënie Civilo-Ushtarake në FSK, 18-05-2011
2. Intervistë me z. Nur Çeku, Komisioni Parlamentar për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK, 17-05-2011
3. Intervistë me një ish udhëheqës të lartë të TMK-së (anonim) 18-05-2011
4. Intervistë me një analist të çështjeve të sigurisë (anonim) 27-05-2011
5. Intervistë me gjeneral Ramadan Qehaja, ushtarak dhe njohës i çështjeve të sigurisë 02-06-2011
6. Intervistë me z. Faruk Geci, udhëheqës i Departamentit për Politika dhe Plane në MFSK, 26-05-2011
7. Intervistë me z. Lars Lage Olofsson, Auditori Gjeneral i Kosovës, 26-05-2011
8. Z.Qerkin Morina, zëdhënës i Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës, 26-05-2011



Forumi për Iniciativa Qytetare (FIQ), është organizatë joqeveritare e përqendruar në sundimin e ligjit që punon për të rritur pjesëmarrjen e qytetarëve në proceset vendimmarrëse, për një rajon ballkanik të zhvilluar ku mbretëron paqja dhe drejtësia. Forumi për Iniciativa Qytetare (FIQ), është organizatë joqeveritare e përqendruar në sundimin e ligjit që punon për të rritur pjesëmarrjen e qytetarëve në proceset vendimmarrëse, për një rajon ballkanik të zhvilluar ku mbretëron paqja dhe drejtësia.



QKSS është themeluar me qëllim të bërjes së studimeve, kërkimeve shkencore, organizimit të konferencave dhe tryezave në sferën e politikave të sigurisë në Republikën e Kosovës. Duke pasur parasysh mungesën e institucioneve jo-publike që merren me këte sferë shumë të rëndësishme, QKSS është një zë i fuqishëm në drejtim të studimeve të sferës së sigurisë.

*Ky raport mbështetet nga Balkan Trust for Democracy*

**B | T | D** The Balkan Trust for Democracy